

**NË EMËR TË POPULLIT**

**GJYKATA E APELIT E KOSOVËS**, në kolegjin e përbërë nga gjyqtarët Ferit Osmani, kryetar i kolegjit, gjyqtarët Hashim Çollaku dhe Biljana Rexhiq, anëtarë, me zyrtarin ligjor Bujar Ahmeti, procesmbajtës, në çështjen penale kundër të akuzuarit M.K. nga Prishtina, për shkak të veprës penale të vjedhjes së rëndë nga neni 327 par. 1 pika 1.1 të KPK, duke vendosur sipas ankesës së mbrojtësit të akuzuarit, av. A.R., të ushtruar kundër aktgjyimit të Gjykatës Themelore në Prishtinë, P.nr.4047/13 të datës 28.05.2018, në seancën e kolegjit të mbajtur me datë 27.08.2018 mori këtë:

**A K T G J Y K I M**

Refuzohet si e pa bazuar ankesa e mbrojtësit të akuzuarit M.K., av. A.R., kurse aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Prishtinë, P.nr.4047/13 të datës 28.05.2018, **vërtetohet.**

**A r s y e t i m**

Me aktgjykimin e ankimuar të Gjykatës Themelore në Prishtinë, P.nr.4047/13 të datës 28.05.2018, është shpallur fajtor i akuzuari M.K., për shkak të veprës penale të vjedhjes së rëndë nga neni 327 par. 1 pika 1.1 të KPK, dhe i është shqiptuar dënimi me burgim në kohëzgjatje prej 6 (gjashtë) muajve, i cili dënim do të ekzekutohet në afat prej 15 ditëve, pas plotfuqishmërisë së aktgjyimit.

Është obliguar i akuzuari që të paguajë shpenzimet e procedurës penale sado që të jenë ato sipas llogarisë së bërë në arkë të gjykatës, si dhe paushallin gjyqësor në shumën prej 35 (tridhjetë e pesë) €, të gjitha këto në afat prej 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve, pas plotfuqishmërisë së aktgjyimit.

I dëmtuari, për realizimin e kërkesës pasurore-juridike, është udhëzuar në kontestin e rregullt juridiko-civil.

Kundër këtij aktgjykimi, në afat ligjor ka ushtruar mbrojtësi i të akuzuarit M.K., av. A.R., për shkak të shkeljeve esenciale të dispozitave të procedurës penale, shkeljes së ligjit penal si dhe vendimit lidhur me sanksionin penal, duke propozuar që aktgjykimi i ankimuar të anulohet dhe çështja penale t'i kthehet gjykatës së shkallës së parë, në rigjykim dhe vendosje.

Prokuroria e Apelit në Prishtinë, me shkresën PPA/II.nr.788/2018, të datës 25.07.2018, duke u sqaruar përkitazi me ankesën e mbrojtësit të akuzuarit M.K., av. A.R., ka propozuar që e njëjta të refuzohet si e pa bazuar, kurse aktgjykimi i ankimuar të vërtetohet.

Gjykata e Apelit, në kuptim të nenit 390 të KPPK, ka caktuar seancën e kolegjit dhe për datën e mbajtjes së të njëjtit i ka njoftuar të gjitha palët nga shkresat e lëndës. Nga shkresat e lëndës rezulton se asnjë nga palët e njoftuara nuk prezantojnë në seancën e kolegjit, edhe pse janë njoftuar me rregull, ashtu që kolegji ka vazhduar me punë pasi janë plotësuar kushtet ligjore.

Gjykata e Apelit, në kuptim të nenit 394 të KPPK, ka vlerësuar pretendimet ankimore nga ankesa e ushtruar, propozimit me shkrim të Prokurorisë së Apelit në Prishtinë, si dhe shkresave tjera të lëndës ka gjetur se:

### **Ankesa e mbrojtësit të akuzuarit M.K., av. A.R., nuk është e bazuar.**

Sipas ankesës së mbrojtësit të akuzuarit, aktgjykimi i gjykatës së shkallës së parë, është ankimuar për shkak të shkeljeve esenciale të dispozitave të procedurës penale, duke theksuar se të njëjtat konsistojnë në kuptim të nenit 384 par. 1 pika 1.3 të KPPK, sepse nga shkresat e lëndës e sidomos nga procesverbali i shqyrtimit kryesor, rezulton se i akuzuari M.K., në asnjë fazë të procedurës e as në shqyrtimin kryesor të çështjes penale P.nr.4047/2013 të dt. 28.05.2018, i akuzuari nuk ka pasur avokat, përkundër asaj që kjo e drejtë i garantohet edhe me kushtetutë të akuzuarit. Gjithashtu, gjykata e shkallës së parë, është dashur që të përkujdeset se nëse i akuzuari nuk ka mjetet të duhura financiare, atij mbrojtja është dashur që t'i sigurohet falas. Po të kishte pasur mbrojtës, me siguri edhe vendimi për dënimin do t'i ishte marrë më i drejtë, e në rastin konkret duke iu referuar dispozitës ligjore nga neni 57 par. 1 pika 1.5 të KPPK, sipas të cilit thuhet: “në të gjitha rastet kur i akuzuari kërkon të hyjë në marrëveshje për pranimin e fajësisë, për veprën penale për të cilën parashihet dënimi me më së paku një vit burgim, i pandehuri duhet të përfaqësohet nga mbrojtësi, ashtu, që në rastin konkret kjo e drejtë nuk i është respektuar dhe mendojmë se bie në kuadër të shkeljeve esenciale absolute, sepse gjykimi është mbajtur pa pranin e personave të kërkuar sipas dispozitës përkatëse ligjore. Pasi që aktgjykimi përfshihet me këto shkelje, atëherë si i tillë është i paqëndrueshëm. Nga aktgjykimi rezulton se në faqen 3 pasusi 3-të, është konstatuar se i akuzuari ka deklaruar se e ka kuptuar aktakuzën dhe e ndien veten fajtor për veprën penale për të cilën akuzohet, që rezulton se e ka pranuar fajësinë përkitazi me veprën penale e cila i vihet në barrë, jemi të mendimit se i akuzuari nuk i ka kuptuar pasojat e pranimit të fajësisë, sepse i akuzuari nuk ka përgatitur të duhur profesionale dhe nuk ka pasur mundësi të kuptojë përmbajtjen e aktakuzës e cila iu është dorëzuar dhe se i njëjti prej fillimit deri në fund të procedurës ka pranuar që të zhvillohet procedura pa mbrojtës. Nga shkresat e lëndës rezulton se me veprimet e të akuzuarit janë formuluar elementet inkriminuese të veprës penale të vjedhjes nga neni 325 par. 2 të KPK, ngase i akuzuari nuk e ka eliminuar pengesën me përdorimin e forcës, por këto janë përfundime jo të drejta të gjykatës së shkallës së parë, andaj, jemi të mendimit se aktgjykimi i ankimuar është marrë edhe duke u shkelur dispozita ligjore nga neni 384 par. 1 pika 1.3 dhe 1.12 si dhe par. 2 pika 2.1 dhe 2.2 të KPPK, ashtu që edhe në këtë drejtim jemi të mendimit që i njëjti duhet anuluar dhe çështja penale duhet t'i kthehet gjykatës së shkallës së parë, në rigjykim dhe vendosje.

Kolegji i Gjykatës së Apelit, e ka shqyrtuar dhe vlerësuar aktgjykimin e ankimuar, sipas ankesës së ushtruar, si dhe shkresat e tjera të lëndës, në kuptim të nenit 394 të KPPK, për të cilat shkelje përkujdeset edhe sipas detyrës zyrtare, dhe ka ardhur në përfundim se dispozitivi i aktgjykimit të gjykatës së shkallës së parë, është i qartë, i kuptueshëm dhe në harmoni me vetveten, dhe me arsyetimin e të njëjtit, sepse përmban arsyet lidhur me faktet vendimtare, të cilat karakterizojnë veprën penale të vjedhjes së rëndë nga neni 327 par. 1 pika 1.1 të KPK, sepse gjykata e shkallës së parë, në përpikëri ka zbatuar dispozitat ligjore nga neni 384 par. 1 pika 1.3 të KPPK, kur të akuzuarin e ka pyetur se a e ka kuptuar çka do të thotë pranimi i fajësisë, se çka nënkupton që të pranohet aktakuza, kurse, i akuzuari ka deklaruar se e ka kuptuar aktakuzën dhe se e ndien veten fajtor për veprën penale e cila i vihet në barrë, ashtu që gjykata e shkallës së parë, në përpikëri ka zbatuar edhe dispozitën ligjore nga neni 248 i KPPK, që ndërlidhet me pranimin e fajësisë gjatë shqyrtimit fillestar. Gjithashtu, është marrë edhe vendimi i prokurorit, përkritazi me respektimin e dispozitave ligjore, i njëjti ka deklaruar se pranimi i fajësisë nga ana e gjykatës është bërë në pajtim me dispozitat përkatëse ligjore, andaj, gjykata ka vazhduar më tutje me procedurë, që nënkupton se nuk është shkelur as dispozita ligjore nga neni 384 par. 1 pika 1.12 lidhur me par. 2 pika 2.1 dhe 2.2 të KPPK, sepse aktgjykimi përmban formën dhe përmbajtjen sikurse parasheh dispozita ligjore nga neni 370 i KPPK, ngase, në arsyetim të njëjtit janë paraqitur arsyet për çdo pikë të aktgjykimit si dhe janë dhënë arsye të qarta se cilat fakte janë të vërtetuara për ta vërtetuar saktësinë e provave sipas të cilave është vendosur çështja penale dhe është bërë zbatimi i dispozitave të caktuara të ligjit për veprën penale e cila i vihet në barrë.

Mbrojtësi i të akuzuarit aktgjykimin e gjykatës së shkallës së parë, e ka ankimuar për shkak të shkeljeve të ligjit penal, të cilat shkelje janë si pasojë e shkeljeve esenciale të dispozitave të procedurës penale, sepse, në rastin konkret i akuzuari Menotor Konjusha, e ka pranuar fajësinë për veprën penale e cila i vihet në barrë, mirëpo, nuk ka qenë i vetëdijshëm se çka do të thotë pranimi i fajësisë, nuk është këshilluar me askënd, e sidomos nuk është këshilluar me personin kompetent, prezenca e të cilit është e detyrueshme në shqyrtim kryesor, andaj, aktgjykimi si i tillë nuk mund të qëndrojë, sepse përfshihet me shkelje të ligjit penale nga neni 385 par. 1 pika 1.4 të KPPK.

Kolegji i kësaj gjykate e ka vlerësuar aktgjykimin e ankimuar sipas ankesës së mbrojtësit të akuzuarit si dhe shkresat e tjera të lëndës, për shkeljet për të cilat pretendohet në ankesë, dhe për të cilat kujdeset edhe sipas detyrës zyrtare, ashtu që ka ardhur në përfundim se aktgjykimi i gjykatës së shkallës së parë, nuk përfshihet me shkeljet e ligjit penal të parapara në kuptim të nenit 385 të KPPK, ngase me të gjitha provat e administruara në shqyrtim gjyqësor janë vërtetuar elementet inkriminuese të veprës penale e cila i vihet në barrë të akuzuarit, se vepra penale për të cilën është akuzuar i akuzuari parashihet me ligjin e aplikueshëm, se janë vërtetuar elementet inkriminuese të veprës penale të cilën e ka pranuar edhe vetë i akuzuari, pasi që janë përmbushur kushtet ligjore, andaj, nuk ekzistojnë rrethana që përjashtojnë të akuzuarin nga përgjegjësia penale dhe ndjekja penale, se gjykata ka vepruar në kuadër të kompetencës ligjore, dhe aktgjykimi i ankimuar është i pranueshëm për kolegjin e kësaj gjykate.

Sipas ankesës së mbrojtësit të akuzuarit, aktgjykimi i gjykatës së shkallës së parë, është ankimuar për shkak të vendimit lidhur me sanksionin penal, duke theksuar e pasi që

aktgjykimi përfshihet me shkelje esenciale të dispozitave të procedurës penale si dhe shkeljet e ligjit penal, si i tillë është i paqëndrueshëm, andaj, ka ushtruar edhe ankesë për shkak të vendimit lidhur me sanksionin penal, pa dhënë ndonjë arsye tjetër, mirëpo kolegji i kësaj gjykate, të njëjtin e ka shikuar sipas detyrës zyrtare sa i përket kësaj baze ankimore, dhe ka ardhur në përfundim, se nga ana e gjykatës së shkallës së parë në mënyrë të drejtë dhe të plotë është vërtetuar gjendja faktike, se aktgjykimi i ankimuar nuk përfshihet me shkeljet esenciale të dispozitave të procedurës penale, si dhe shkeljet e ligjit penal, ashtu që kolegji pas vlerësimit të aktgjykimit, vie në përfundim se gjykata e shkallës së parë, në mënyrë të drejtë ka vlerësuar rrethanat të cilat ndikojnë me rastin e marrjes së vendimit për dënimin, caktimit të llojit dhe lartësisë së tij, në kuptim të nenit 73 të KPK, sikurse janë rrethanat lehtësuese, se i akuzuari e ka pranuar fajësinë për veprën penale e cila i vihet në barrë kurse rrethana renduese nuk gjeti, e gjithashtu, nuk ka gjetur edhe ndonjë rrethanë posaçërisht lehtësuese, sikurse pretendon mbrojtësi i të akuzuarit në ankesën e ushtruar, kolegji i kësaj gjykate, është i bindur se me dënimin e shqiptuar nga ana e gjykatës shkallës së parë, do të arrihet efekti dhe qëllimi i tij i paraparë me nenin 41 të KPK, që të parandaloj kryerësin nga kryerja e veprave penale në të ardhmen dhe të bëjë rehabilitimin e tij, të parandaloj personat e tjerë nga kryerja e veprave penale, të bëjë kompensimin e viktimave ose të komunitetit për humbjet ose dëmet e shkaktuara nga vepra penale, dhe të shpreh gjykimin shoqëror për veprën penale, ngritjen e moralit dhe forcimin e detyrimit për respektimin e ligjit.

Nga sa u tha më lartë, e në pajtim me dispozitën e nenit 401 të KPPK, u vendos sikurse në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

**GJYKATA E APELIT E KOSOVËS**  
**PA1. nr.782/2018, të datës 27.08.2018**

**Zyrtari ligjor,**  
**Bujar Ahmeti**

**Anëtarët e kolegjit**  
**Hashim Çollaku**

**Kryetar i kolegjit**  
**Ferit Osmani**

**Biljana Rexhiq**